

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
 - **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
 - **Stafi KQZ: Znj. V. Ballgjini, znj. K. Nogu, znj. E. Allushi.**
- **Parti Politike: S’ka prezent!**
- **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Në seancën e ditës së sotme kemi në rendin e ditës katër çështje. Kemi:

Projektvendimin: “Për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme”;

Projektvendimin: “Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së nr. 11, Bashkia Kukës, për zgjedhjet e pjeshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”;

Projektvendimin: “Për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të Komisionit të Zonës të Administrimit Zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet e pjeshme për Kryetar të Bashkisë Kukës” dhe

Projektvendimin: “Për akreditimin e vëzhguesve jopolitikë nëpërmjet platformës elektronike të vëzhguesve, për zgjedhjet e pjeshme për Kryetar të Bashkisë Kukës. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me përcaktimin e vlerës në para të një vote, po Valbona!

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.08.2023*

Znj. V. Ballgjini: Referuar nenit 88, pika 2, të Kodit Zgjedhor, parashikon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga nxjerrja e rezultatit përfundimtar në shkallë vendi, përcakton me vendim vlerën në para të 1 (një) vote të vlefshme, duke pjesëtuar fondin e përgjithshëm të miratuar nga buxheti i shtetit, me numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, që kanë marrë jo më pak se 1 përqind të votave të vlefshme në shkallë vendi. Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, llogaritja bëhet mbi bazën e votave të marra për këshillat vendorë në shkallë vendi. Në datë 7.8.2023, Komisioni Rregullator, miratoi vendimin nr. 27, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”. Në lidhjen nr. 2 përcaktohen votat e vlefshme dhe përqindja e fituar nga çdo subject zgjedhor, pjesëmarrës në zgjedhje. Subjekte zgjedhore që kanë përfituar jo më pak se 1 përqind të votave të vlefshme të grumbulluara prej tyre, janë 13, përkatësisht:

Partia Socialiste e Shqipërisë;	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet;
Koalicioni Bashkë Fitojmë;	Partia Lëvizja e Legalitetit;
Partia Demokratike;	Aleanca Progresiste;
Partia Socialdemokrate;	Partia Demokracia Sociale;
Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë;	Fryma e Re Demokratike;
Partia Republikane Shqiptare;	Aleanca Liberale e Djalës;
	Partia e Gjelbër .

Gjithsej vota të vlefshme që kanë marrë partitë pjesëmarrëse në zgjedhje mbi 1% është 1.242.641 vota. Përllogaritja do të bëhet duke pjesëtuar fondin e vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023 që ishte 100.00.000 (njëqind milion) lekë, pjesëtuar me numrin e votive të vlefshme pra, 1.242.641 (një milion e dyqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e dyzet e një) vota, rezultati it ë cilave është 80.47 (tetëdhjetë e dyzet e shtatë) lekë për votë. Duke bërë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.08.2023*

një përlogaritje 81 lekë për votë. Pra çmimi i një vote të vlefshme, rezulton të dalë 81 lekë për votë. Në referim të nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, ju propozojmë për miratim projektvendimin.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Këtë projektakt ne e kemi konsultuar dhe me partitë politike dhe me organizat e shoqërisë civile. Kemi pas komente vetëm nga organizata KRIIK.

Znj. V. Ballgjini: Po!

Z. I. Celibashi: Nga partitë politike nuk kemi pas komente

Znj. V. Ballgjini: Jo!

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë, miratojmë projektaktit sipas draftit të paraqitur sipas të cilës përcaktojmë vlerën në para të një vote të vlefshme në shumën e 81 lekëve.

Vendimi nr. 727

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.08.2023*

24.08.2023

Ora 12:07

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarit të KZAZsë nr. 11, Bashkia Kukës, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
 - **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
 - **Stafi KQZ: Znj. V. Ballgjini, Znj. K. Nogu, Znj. E. Allushi.**
- **Parti Politike: S’ka prezent!**
- **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës që ka të bëjë me emërimin e anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së nr. 11, Bashkia Kukës. Po!

Znj. K. Nogu: Referuar nenit 29, pika 1, shkronja “c” të Kodit Zgjedhor, dhe nenit 7 të rregullores për organizimin dhe funksionimin e KZAZ-ve, të miratuar me vendimin e Komisionit Rregullator nr. 5 të vitit 2020, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve emëron anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve. Me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 722, datë 19.08.2023 janë caktuar partitë politike të cilat kanë të drejtën për të propozuar anëtarët dhe sekretarin e KZAZ nr. 11 për zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e Bashkisë Kukës. Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia e Lirisë dhe Partia Demokratike depozituan kandidaturat për anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së nr. 11. Të dhënat e kandidaturave të paraqitura, u verifikuan për plotësimin e kushteve të përcaktuara në nenin 29 pika 1, germa “c” dhe “ç”, nenin 30 dhe nenin

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.08.2023*

31, të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu janë verifikuar të dhënat e kandidaturave dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe rezulton se kandidaturat plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 30, dhe 31, të Kodit Zgjedhor, si dhe nuk figurojnë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë atëherë, miratojmë anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së nr. 11 sipas propozimeve të sjella nga Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia e Lirisë dhe Partia Demokratike, sipas së cilës:
katër anëtarë të KZAZ-së i takojnë Partisë Socialiste;
dy anëtarë i takojnë Partisë së Lirisë dhe,
një anëtar i takon Partisë Demokratike;
sekretari i takon Partisë së Lirisë.

Vendimi nr. 728

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.08.2023*

24.08.2023

Ora 12:09

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të Komisionit të Zonës të Administrimit Zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
 - **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
 - **Stafi KQZ: Znj. V. Ballgjini, Znj. K. Nogu, Znj. E. Allushi.**
- **Parti Politike: S’ka prezent!**
- **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës që ka të bëjë me ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të Komisionit të Zonës të Administrimit Zgjedhor.

Znj. K. Nogu: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në bazë të nenit 8, të rregullores për organizimin dhe funksionimin e KZAZ-ve, të miratuar me vendimin nr. 5 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator, merr vendimin për ngritjen e KZAZ-ve. Përcakton selinë, orën kur do të zhvillohet mbledhja e parë e KZAZ-së. Njofton partitë politike që kanë propozuar anëtarët e KZAZ-ve për datën, vendin dhe orën e mbledhjes së parë të KZAZ-së. Kryetari në detyrë i Bashkisë Kukës me shkresën nr. 6607 prot., datë 18.8.2023, ka dërguar vendndodhjen e selisë së KZAZ-së në ambjentin e Pallatit të Kulturës “Hasan Prishtina”, kati i dytë Kukës, si dhe është kujdesur për

***Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU***


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.08.2023*

infrastrukturën e nevojshme të zhvillimit të seancave të KZAZ-së. Bashkëlidhur projektvendimi për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, mbledhja e parë do të zhvillohet në datën 25 gusht, për orën do ta vendosim më vonë dhe do të komunikojmë me anëtarët e KZAZ-së. Mirë, faleminderit!

Vendimi nr. 729

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.08.2023*

24.08.2023

Ora 12:11

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për akreditimin e vëzhguesve jopolitikë nëpërmjet platformës elektronike të vëzhguesve, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
 - **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
 - **Stafi KQZ: Znj. V. Ballgjini, Znj. K. Nogu, Znj. E. Allushi.**
- **Parti Politike: S’ka prezent!**
- **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës. Po!

Znj. E. Allushi: Referuar neneve 6, 7 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave”, kemi propozuar që ashtu si dhe për zgjedhjet e përsëritura për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, edhe për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 shtator 2023, akreditimi i vëzhguesve jopartiak do të bëhet edhe nëpërmjet Platformës Elektronike të Vëzhguesve. Bashkëlidhur projektvendimi. Kemi pasur dia komente nga KRIIK-u. Një pjesë e tyre janë adresuar dhe pjesa tjetër do të adresohen.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.24.08.2023*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë atëherë, miratojmë edhe këtë akt sipas draftit të paraqitur duke ju mundësuar organizatave të shoqërisë civile vendase, të huaja dhe medias për të akredituar vëzhgues nëpërmjet platformës përkatëse elektronike, ashtu si dhe për zgjedhjet e përsëritura për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë.
Mirë, faleminderit! Çështje të tjera nuk kemi. Seanca mbyllet, ditë të mbarë!

Vendimi nr. 730

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

